

## **UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E APLIKACIONIT PËR REGJISTRIMIN E DIZAJNIT INDUSTRIAL**

Procedura e regjistrimit fillon me paraqitjen e aplikacioni të plotësuar në Agjencinë për Pronësi Industriale.

Aplikacioni merret në Agjencinë për Pronësi Industriale të MTI-së, apo nga web- site zyrtar i API-së: <http://kipa.rks-gov.net/>.

Aplikacioni për regjistrimin e dizajnit industrial plotësohet në gjuhën zyrtare vetëm me kompjuter dhe nuk duhet të plotësohet me dorë.

Disa shpjegime për plotësimin e aplikacionit:

### ***Aplikacioni***

#### ***Rubrika nr 2, të dhënat për paraqitësin e aplikacionit***

Personi fizik, emri, mbiemri (të dhënat të shënohen sipas radhës): rruga, numri, numri postar, qyteti, shteti, tel/fax dhe e-mail adresa, deklarata për përfaqësuesin e përbashkët apo

Personi juridik, emri, rruga, numri, numri postar, qyteti, shteti, tel/fax dhe e-mail adresa

#### ***Rubrika 3***

Të dhënat për përfaqësuesin: emri dhe mbiemri (për personin fizik), për personin juridik (emri i plotë i personit juridik), adresa; rruga, numri, numri postar, qyteti, shteti, tel, telefax, e-mail adresa.

#### ***Rubrika 4, shuma e taksës së paguar***

Shuma bazë dhe shuma shtesë për secilin dizajn nëse ka të tillë,

#### ***Rubrika 5- Emri i produktit***

Emri dhe lloji i produktit duhet të jetë i shkruar qartë në gjuhën shqipe, jo në gjuhë të huaj e as emri komercial , p.sh.: “shishe”; “tavolina”, “orë dore”etj.

#### ***Rubrika 6***

Shënimi i klasës së produktit nuk është i obligueshëm. Klasifikimin e shënon zyrtari i API-së me rastin e pranimit të aplikacionit kur e verifikon nëse është plotësuar drejt apo jo.

Nëse pala dëshiron të paraqet aplikacioni për regjistrimin e dizajnit të disa llojeve të produkteve, të gjitha dizajnet e paraqitura në aplikacioni duhet t'i takojnë të njëjtës klasë sipas klasifikimit ndërkombëtar

#### ***Rubrika 7***

Të dhënat për dizajnuerin

Dizajnueri gjithmonë është person fizik.

Në rastet kur dizajnueri nuk dëshiron të ceket në aplikacion, kjo mund të bëhet nepërmjet një deklarate me shkrim nga dizajnueri.

#### ***Rubrika 8***

Në rastet kur kërkohet e drejta e përparësisë se Unionit duhet të shenohet në aplikacion data, numri, emri i shtetit, dëshmitë e bashkangjitura. Ndërsa kur kërkohet e drejta e përparësisë nga ekspozita, emri i ekspozitës, data e hapjes dhe e mbylljes se ekspozites, data e ditës së parë të ekspozitës, dëshmitë e bashkangjitura.

### ***Rubrika 9***

Përshkrimi i dizajnit apo mostrës nuk është i domosdoshëm. Nëse pala ka dëshirë atëherë mund ta përshkruaj dizajnin, por jo me më shumë se 100 fjalë për çdo dizajn.

Aplikacioni i plotësuar për regjistrimin e dizajnit industrial duhet ta ketë nënshkrimin e titullarit apo përfaqësuesit të tij dhe datën e pranimit, nënshkrimin e zyrtarit që e ka pranuar dhe vulën e Zyrës së Pronësisë Industriale.

### ***Rubrika 10***

Në rastet kur kërkohet shtyerja e publikimit, bëhet me kërkesën e palës, ku shenohet edhe periudha e shtyerjës së publikimit dhe kur paraqitja e dizajnit bëhet me mostër. Në rastet kur paraqitet aplikacioni i ndarë nga aplikacioni i shumëfishtë shënohet numri i aplikacionit të parë.

Dhe rubrika e fundi nga ana e majte nënshkruhet apo vulozet nga ana e paraqitesit të aplikacionit

### **Aplikacioni**

Në aplikacion paraqitet pamja e dizajnit që kërkohet të regjistrohet.

Çdo dizajn mund të paraqitet në shtesë të veçantë në më së shumti gjashtë pamje.

Në rubrikën për numrin e dizajnëve shënohet numri i përgjithshëm i dizajnëve si p.sh., 1.1, 1.2, deri te 1.6 për dizajnin e parë, 2.1, 2.2, deri në 2.6 për dizajnin e dytë e kështu me radhë.

Në hapësirën për paraqitjen e pamjes së dizajnit ngjitet, apo në mënyrë elektronike shtypet, paraqitja grafike apo fotografia e dizajnit, dimensionimi i të cilës nuk bën të jetë më e vogël se 4x4 cm